PSH .nr.327/20
351/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068,dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të: z. Goran Milenković - Kryetar, z. Nuhi Paçarizi - Referues, z. Blerim Dina - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: OE N.SH.H "ZONA PARK"-Prizren, me numër te protokollit 327/20, lidhur me aktivitetin e prokurimit ankesa është parashtruar kundër vendimit te AK-së Njoftimit për Anulim te aktiviteti te prokurimit me titull "Sigurimi fizik dhe mirëmbajtja e objekteve të administratës Komunale Prizren", me nr. të prok: "622-19-9525-2-1-1(LOT 2), si dhe ankesës së OE "Rosa Security"- shpk & Delta Security sh.p.k - Prizren, me numër te protokollit 351/20 , kundër njoftimit për dhënie të kontratës, ku për LOT 1 ku është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik: "GEO Comando shpk &Security Code" Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik dhe mirëmbajtja e objekteve të administratës Komunale Prizren", me nr. të prok: "622-19-9525-2-1-1" (LOT 1) të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prizren, më datën: 08.07.2020, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: N.SH.H "ZONA PARK"-Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik dhe mirëmbajtja e objekteve të administratës Komunale Prizren", me nr. të prok: "622-19-9525-2-1-1"LOT 2, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prizren.

II.ANULOHET , njoftimi për anulim të aktiviteti te prokurimit me titull: "Sigurimi fizik dhe mirëmbajtja e objekteve të administratës Komunale Prizren", me nr. të prok: "622-19-9525-2-1-1 për LOT 2, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prizren dhe lënda kthehet në Rivlerësim për LOT 2.

III.HEDHET si e pa lejuar , ankesa e operatorit ekonomik "Rosa Security"- shpk & Delta Security sh.p.k - Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik dhe mirëmbajtja e objekteve të administratës Komunale Prizren", me nr. të prok: "622-19-9525-2-1-1"LOT 1 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prizren.

IV.VËRTETOHET, njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik dhe mirëmbajtja e objekteve të administratës Komunale Prizren", me nr. të prok: "622-19-9525-2-1-1" për LOT 1 të iniciuar nga AK- Kuvendi Komunal Prizren.

V. Autoriteti Kontraktues në afat prej 15 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

VI .Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

VII. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues N.SH.H "ZONA PARK"-Prizren, aprovohet pjesërisht si e bazuar, ndërsa ankesa e operatorit ekonomik ankues "Rosa Security"- shpk & Delta Security sh.p.k - Prizren, hedhet si e pa lejuar ankuesve iu bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VIII .Obligohen operatoret ekonomik ankues, që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjnë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A R S Y E T I M

Operatori ekonomik ankues OE N.SH.H "ZONA PARK"-Prizren, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 26.05.2020 me nr.327/20, kundër njoftimit për anulim te aktiviteti te prokurimit me titull: "Sigurimi fizik dhe mirëmbajtja e objekteve të administratës Komunale Prizren", me nr. të prok:19-9525-2-1-1"LOT 2, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prizren, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7, 28, 59, 60 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, Ligjin e Punës Nr.03/L-212, nenin 18 të RRUOPP-së si dhe vendimi i OSHP-së Nr.167/20 i dt:07.04.2020.

Operatori ekonomik ankues OE "Rosa Security"- shpk & Delta Security sh.p.k - Prizren, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me dt: 03.06.2020 me nr.351/20, kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi fizik dhe mirëmbajtja e objekteve të

administratës Komunale Prizren", me nr. të prok: "622-19-9525-2-1-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues /AK/ Kuvendi Komunal Prizren LOT 1, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 1, 6, 7, 52, 59, 72 dhe nenin 108/A të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 28.05.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore për lëndën 327/20.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt:01.06.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: N.SH.H "Zona Park" – Prizren (327/20)

Përgjigje në Pretendimi Nr. 1, Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Autoriteti kontraktues ne lidhje me procesin e ri-vlerësimit, përsëri ne eliminon nga procedura e këtij aktiviteti te prokurimit me te njëjtat arsyetime se nuk përmbushim kapacitetin teknik dhe profesional pjesa e kontratave te realizuara nuk kap vlerën prej 500,000.00€. Po ashtu nuk i keni marre parasysh edhe kontrata tjerat e cilat kane qene te natyrës se njëjte, ju keni mundur te kërkoni edhe dëshmi tjera sipas Nenit 72 të LPP-se edhe për kontrata tjera e jo vetëm për një (1) për Universitetin e Prizrenit. Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, OE ankues ne platformën elektronike e-prokurimi ka dorëzuar 2 (dy) lista te kontratave te nënshkruar dhe te vulosura njëra ne vlere: 711.039.88 €, kurse tjetra ne vlere: 1,847,259.99 €, duke bashkangjitur: kontrata, referenca, raporte te pranimeve etj.., Komisioni i vlerësimit ne raportin e datës 19.05.2020 tek deklarate vlerëson se OE ankues ka kontrata dhe referenca ne vlere 487,213.23 €, mirëpo komisioni i vlerësimit nuk ka kërkuar sqarime (duke respektuar pjesërisht Vendimin e OHSP-se nr. 167/20 te datës 07.04.2020) dhe nuk ka vlerësuar kontratën e prezantuar ne listën e kontratave nga OE ankues te lidhur me Komunën e Gjakovës e cila hynë ne fuqi nga data 20.10.2016 deri 31.10.2017, me titull: Mirëmbajtja –Pastrimi i objekteve te KPSH-se dhe QPS-së me nr. prokurimi: 632-16-030-221, e cila ne nenin 3 te kësaj kontrate, vlera e parashikuar për shpenzime te kësaj kontrate kornize është: 73,963.00 €, andaj, bazuar ne këto dëshmi dhe duke pas parasysh Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nenin 9.1 & 9.2 te FDT-se, Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjte gjatë 3 (tri) viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë) jo më pak se Për loto 2= 500,000.00 €. Dëshmia 1

Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosjen elektronike, , të dëshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të shërbimeve, OE ankues arrin te plotësoj këtë kërkesë te dosjes se tenderit, andaj konsideroj se AK - komisioni i ri-vlerësimit nuk ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar drejt ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, me fjale tjera nuk e ka respektuar nenin 7 paragrafi 2 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik" si dhe neni 59 par. 4 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit", si dhe nenin 60 par.1 pika 1.1 të LPP-së, po citoj: "Autoriteti kontraktues do t'ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët". Gjithashtu, Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, OE ankues ka prezantuar edhe disa kontrata shërbime te DDD (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim) te cilat konsideroj se hynë ne lëmin (natyrës se njëjtë) te pastrimit dhe mirëmbajtjes, gjate tri viteve te fundit (duke filluar nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë), ashtu siç është kërkuar ne njoftim për kontratë dhe dosje te tenderit. Eksperti shqyrtues sqaron, lidhur me këtë pretendim mendon se AK – komisioni i vlerësimit, nëse ka pasur dyshime ka mundur të kërkoj sqarime shtesë bazuar në nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe bazuar ne nenin 39 te RrUOPP-së. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr.2, Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, autoriteti kontraktues duhet te drejtohet me kërkese për futje ne listën e zeze, konfirm Nenit 99.2 të LPP-së për OE "SFK" Sh.p.k. i cili ka qene i rekomanduar nga AK, pasi qe ka renë ne kundërshtim me Nenin 65 te LPP-së dhe deklarate nen betim, sepse i njëjti është deklaruar qe: "pranon mundësin e sanksioneve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse për shkak te pakujdesisë dorëzon çfarëdo dokumenti ose deklarate qe përmbana informata përmbajtësish te gabueshme ose mashtruese", pasi i njëjti tregon se e ka sjella këtë vërtetim mirëpo figuron se ka borxhe andaj edhe komisioni e ka shpall te papërgjegjshëm.

Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, konsideron se është ne diskrecionin dhe përgjegjësin e autoriteti kontraktues, te beje një kërkesë me shkrim në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik. Pasi qe OSHP është e obliguar dhe ka autoritetin që të shqyrtojë, vetëm pas pranimit te një

kërkesë me shkrim nga autoriteti kontraktues. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë nuk është i qëndrueshëm.

Përgjigje në Pretendimi nr.3, Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 28 dhe 108/A të LPP-së. Eksperti shqyrtues sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, operatori ekonomik ankues i ka ngritur si pretendime tek dispozitat ligjore, kurse tek deklarata detale e fakteve dhe argumenteve nuk ka sqaruar se si dhe ne cilin/cilat rast/e autoriteti kontraktues ka shkelur këto nene të LPP-së, duke mos precizuar se pse nuk janë respektuar këto nene. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK te lartpërmendur dhe analizës se mësipërme vlerësojë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë, nuk është i qëndrueshëm.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues, të aprovohet si e bazuar, dhe rekomandon të anulohet B58-Njoftimi mbi vendimin e AK (njoftimit për dhënie të kontratës) dhe lënda të kthehet në Ri-vlerësim.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 04.06.2020, ka autorizuar ekspertin profesional të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore për lëndën 351/20.

Eksperti profesional i prokurimit në raportin e dt:09.06.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:
PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES: K.S. "Rosa Security" Sh.p.k. &"Delta Security"Sh.p.k. – Prizren; Lot. 1

Përgjigje në Pretendimi nr.1, Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7, 52, 59, 72 të LPP-së. Eksperti shqyrtues sqaron, se marr për bazë që ky aktivitet i prokurimit është për herë 2 (dytë) që operatoret ekonomik pjesëmarrës ne këtë aktiviteti te prokurimit ankohen, andaj marr për bazë rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, ne vlerësimin e parë grupi i OE: K.S. "Rosa Security" Sh.p.k. & "Delta Security"Sh.p.k.– Prizren; Lot. 1, pasi pranimit te letrës standarde te eliminimit te datës 16.03.2020, u pajtua me vendimin e AK dhe nuk vazhdoi me kërkesën për rishqyrtim pran AK dhe as ankesën pastaj pran OSHP-së, pastaj një OE tjetër pjesëmarrës parashtron

kërkesë për rishqyrtim pran AK dhe pastaj pran OSHP-së. Me vendim te OSHP te datës 08.05.2020 ky aktivitet i prokurimit kthehet ne rivlerësim. Pasi pranimit te letrës standarde te eliminimit te datës 19.05.2020, tani nuk pajtohet me arsyetimin e eliminimit, sikurse ne letrën standarde te datës 16.03.2020, tani ne kërkesën për rishqyrtim pran AK tek deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet, kërkon te anulohet ne tërësi ky aktivitet i prokurimit, ndërsa ne ankesën ne OSHP, kërkon qe lënda te kthehet ne rivlerësim, prandaj duke pas parasysh se ky aktivitet i prokurimit është shqyrtuar edhe me pare pran OSHP-së me vendimin nga PSH .nr. 220/19 të datës 08.05.2019, konsideroj se grupi i juaj i OE ankues, nuk ka arritur të dëshmoj interes material nga rezultati i këtij aktiviteti të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues dhe në pajtim të nenit 4 par. 1 pika 26 të LPP-së, e të cilin thuhet: Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar, andaj pretendimet e grupit të OE ankues, nuk janë trajtuar nga eksperti shqyrtues.

Mendimi i ekspertit shqyrtues: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e grupit te OE ankues, të refuzohet si e pa bazuar, dhe rekomandon të mbetet ne fuqi B58- Njoftimi mbi vendimin e autoriteti kontraktues (vendimi për dhënie të kontratës).

Autoriteti Kontraktues, me datë: 02.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues për lëndën 327/20, ndërsa Autoriteti Kontraktues, me datë: 10.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues për lëndën 351/20 .

Operatori Ekonomik N.SH.H "ZONA PARK"-Prizren, me datë: 02.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Operatori Ekonomik "Rosa Security"- shpk & Delta Security sh.p.k - Prizren, me datë: 10.06.2020, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 08.07.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave,

njoftimi për dhënie të kontratës, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit profesional të prokurimit, dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se te dy ankesat për te dyja LOTE janë parashtruar kundër njoftimit për dhënie te kontratës.

Paneli shqyrtues në vijim jep konstatimet lidhur me ankese e OE N.SH.H "Zona Park" – Prizren (327/20) me numër te protokollit 327/20

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se Autoriteti kontraktues ne lidhje me procesin e ri-vlerësimit, përsëri ne eliminon nga procedura e këtij aktiviteti te prokurimit me te njëjtat arsyetime se nuk përmbushim kapacitetin teknik dhe profesional pjesa e kontratave te realizuara nuk kap vlerën prej 500,000.00€. Po ashtu nuk i keni marre parasysh edhe kontrata tjerat e cilat kane qene te natyrës se njëjte, ju keni mundur te kërkoni edhe dëshmi tjera sipas Nenit 72 të LPP-se edhe për kontrata tjera e jo vetëm për një (1) për Universitetin e Prizrenit.

Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues profesional sqaron, se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, konstaton se OE ankues ne platformën elektronike e-prokurimi ka dorëzuar 2 (dy) lista te kontratave te nënshkruar dhe te vulosura njëra ne vlere: 711.039.88 €, kurse tjetra ne vlere: 1,847,259.99 €, duke bashkangjitur: kontrata, referenca, raporte te pranimeve etj.., Komisioni i vlerësimit ne raportin e datës 19.05.2020 tek deklarate vlerëson se OE ankues ka kontrata dhe referenca ne vlere 487,213.23 €, mirëpo komisioni i vlerësimit nuk ka kërkuar sqarime (duke respektuar vetëm pjesërisht Vendimin e OHSP-se nr. 167/20 te datës 07.04.2020) dhe nuk ka vlerësuar kontratën e prezantuar ne listën e kontratave nga OE ankues te lidhur me Komunën e Gjakovës e cila hynë ne fuqi nga data 20.10.2016 deri 31.10.2017, me titull: Mirëmbajtja –Pastrimi i objekteve te KPSH-se dhe QPS-së me nr. prokurimi: 632-16-030-221, e cila ne nenin 3 te kësaj kontrate, vlera e parashikuar për shpenzime te kësaj kontrate kornize është: 73,963.00 €, andaj, bazuar ne këto dëshmi dhe duke pas parasysh Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale nenin 9.1 & 9.2 te FDT-se, Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjte gjatë 3 (tri) viteve të fundit (duke filluar nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë) jo më pak se Për loto 2= 500,000.00 €. Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali)

për dosien elektronike, , të dëshmuara me referenca dhe kontrata të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të shërbimeve, nga te cekurat si me lart, Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional konstaton se OE ankues arrin te plotësoj këtë kërkesë te dosjes se tenderit dhe se AK - komisioni i ri-vlerësimit nuk ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar drejt ofertat e operatoreve ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, me fjale tjera nuk e ka respektuar nenin 7 paragrafi 2 të LPP-së, dhe nenin 59 të LPP-së.

Paneli shqyrtues konfom Ekspertit shqyrtues profesional konstaton se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, shihet OE ankues ka prezantuar edhe disa kontrata shërbime te DDD (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim) te cilat konsiderojmë se hynë ne lëmin (natyrës se njëjtë) te pastrimit dhe mirëmbajtjes, gjate tri viteve te fundit (duke filluar nga data e publikimit të këtij njoftimi për kontratë), ashtu siç është kërkuar ne njoftim për kontratë dhe dosje te tenderit, andaj me rastin e rivlerësimit AK – komisioni i vlerësimit, nëse ka dyshime lidhur me dëshmitë e lartcekura mundur të kërkoj sqarime shtesë bazuar në nenin 59.2 dhe 72 të LPP-së, si dhe bazuar ne nenin 39 te RrUOPP-së. Duke u bazuar ne këto fakte dhe duke pas parasysh kërkesën e AK të lartpërmendur dhe analizës se mësipërme konstatojmë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë është i qëndrueshëm.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues duhet te drejtohet me kërkese për futje ne listën e zeze, konfirm Nenit 99.2 të LPP-së për OE "SFK" Sh.p.k. i cili ka qene i rekomanduar nga AK, pasi qe ka renë ne kundërshtim me Nenin 65 te LPP-së dhe deklarate nen betim, sepse i njëjti është deklaruar qe: "pranon mundësin e sanksioneve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse për shkak te pakujdesisë dorëzon çfarëdo dokumenti ose deklarate qe përmbana informata përmbajtësish te gabueshme ose mashtruese", pasi i njëjti tregon se e ka sjella këtë vërtetim mirëpo figuron se ka borxhe andaj edhe komisioni e ka shpall te papërgjegjshëm.
Paneli shqyrtues konform Ekspertit shqyrtues sqaron, se në pajtim me nenin 99 te LPP-së OSHP është e thirrur qe te merr masa ndaj OE-ve, për paraqitjen e te dhënave te rreme ose te një dokumenti te falsifikuar pas kërkesës se autoriteti kontraktues te ushtruar në OSHP, është ne diskrecionin dhe përgjegjësin e autoriteti kontraktues, te beje një kërkesë me shkrim në lidhje me paraqitjen e të dhënave të rreme ose të një dokumenti të falsifikuar nga operatori ekonomik për rastin për te cilit i referohet ankuesi AK bart përgjegjësin ligjore nëse është në njohuri lidhur me pretendimet e ankuesit dhe nuk vepron në pajtim me nenin 99 te LPP-së.

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 28 dhe 108/A të LPP-së. Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional sqaron se, duke u bazuar ne

analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike e-prokurim, rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, shihet se operatori ekonomik ankues pretendimet e lartcekura i ka ngritur si pretendime tek dispozitat ligjore, kurse tek deklarata detale e fakteve dhe argumenteve nuk ka sqaruar se si dhe ne cilin/cilat rast/e autoriteti kontraktues ka shkelur këto nene të LPP-së, duke mos precizuar se pse nuk janë respektuar këto nene. Andaj duke u bazuar ne te cekurat si me lart konstatojmë se pretendimi i palës në ankese në këtë pikë, nuk është i qëndrueshëm.

Paneli shqyrtues me poshtë jep konstatimet lidhur me pretendimet e OE ANKUES: K.S. "Rosa Security" Sh.p.k. &"Delta Security"Sh.p.k. – Prizren; Lot. 1, me numër te protokollit 351/20

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues, se autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1, 6, 7, 52, 59, 72 të LPP-së.

Paneli shqyrtues sqaron se OE ANKUES: K.S. "Rosa Security" Sh.p.k. &"Delta Security" Sh.p.k. – Prizren; Lot. 1, në ankesën e tij nuk ka dhen asnjë pretendim lidhur me OE të rekomanduar për dhënie te kontratës, andaj paneli konstaton se AK-komisioni i vlerësimit bart përgjegjësin ligjor (në baze te LPP-së dhe deklaratave nën betim) lidhur me vlerësimin dhe rekomandimin për dhënie te kontratës te OE "GEO Comando shpk &Security Code" Prizren, për lote 1, sepse OSHP nuk ka mundur te vërtetoj përgjegjshmërinë e OE në fjalë, sepse ne vendimin PSH 220/20 paneli ka kërkuar qe ndaj OE te kërkohen sqarime ne pajtim me nenin 59 dhe 72 te LPP-së dhe OE ankues ne ankesën e tij me numër te protokollit 351/20 nuk e konteston përgjegjshmëri e OE te rekomanduar për dhëni te kontratës.

Sqarojmë se në vendimin PSH nr. 220/20,te datës 08.05.2020, OE ankues është K.S Besa Sekurity sh.p.k. Prishtinë, ndërsa OE i rekomanduar për dhënie te kontratës është OE "GEO Comado shpk & Security Code" Prishtinë, ne ketë vendim është konstatuar se OE ankues është i pa përgjegjshëm (arsyet referoju vendimin në fjalë), dërsi për OE të rekomanduar për dhënie te kontratës është obliguar AK qe me rastin e Rivlerësimit te veproj në pajtim me nenin 59 dhe 72 te LPP-së(arsyet referohu vendimit te lartcekur).

Paneli shqyrtues konform ekspertit shqyrtues profesional sqaron, marr për bazë që ky aktivitet i prokurimit është për herë 2 (dytë) që operatoret ekonomik pjesëmarrës ne këtë aktiviteti te prokurimit ankohen, andaj marr për bazë rrjedhën dhe analizën procedurës se prokurimit, ne vlerësimin e parë grupi i OE: K.S. "Rosa Security" Sh.p.k. & "Delta Security"Sh.p.k.– Prizren; Lot. 1, pasi pranimit te letrës standarde te eliminimit te datës 16.03.2020, u pajtua me vendimin e AK dhe nuk vazhdoi me kërkesën për rishqyrtim pran AK dhe as ankesën pastaj pran OSHP-së, pastaj një OE tjetër pjesëmarrës parashtron kërkesë për rishqyrtim pran AK

dhe pastaj pran OSHP-së. Me vendim te OSHP te datës 08.05.2020 ky aktivitet i prokurimit kthehet ne rivlerësim. Pasi pranimit te letrës standarde te eliminimit te datës 19.05.2020, tani nuk pajtohet me arsyetimin e eliminimit, sikurse ne letrën standarde te datës 16.03.2020, tani ne kërkesën për rishqyrtim pran AK tek deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet, kërkon te anulohet ne tërësi ky aktivitet i prokurimit, ndërsa ne ankesën ne OSHP, kërkon qe lënda te kthehet ne rivlerësim, si dhe duke pas parasysh se ky aktivitet i prokurimit është shqyrtuar edhe me pare pran OSHP-së me vendimin nga PSH .nr. 220/19 të datës 08.05.2019, konstatojmë se grupi i OE "K.S. "Rosa Security" Sh.p.k. &"Delta Security"Sh.p.k. – Prizren, nuk ka arritur të dëshmoj interes material nga rezultati i këtij aktiviteti të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues dhe në pajtim të nenit 4 par. 1 pika 26 të LPP-së, e të cilin thuhet: Palë e interesuar - personi që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i aktivitetit të prokurimit të zbatuar nga autoriteti kontraktues në raport me një kontratë të veçantë publike ose konkurs projektimi duke përfshire cilindo person i cili ka qenë ose mund të jetë në rrezik të dëmtimit nga një shkelje e pretenduar, prandaj edhe ankesa e tij hedhet si e pa lejuar .

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues

z. Goran Milenković

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- Kuvendi Komunal Prizren

1x1 OE - N.SH.H "ZONA PARK"-Prizren

1x1 OE "Rosa Security"- shpk & Delta Security sh.p.k - Prizren,

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.